



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 05 mars 2021, në mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

E mbajtur për nderë të Shënimit të “EPOPESE sË UÇK-së” dhe për qëllim shënimin dhe promovimit të vlerave të luftës së UÇK-së dhe kontributin e familjeve të Dëshmorëve për lirinë e Kosovës

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në ndërtesën e re të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç znj.Liridona Shabani, znj.Arlinda Kadriu, znj.Valbone Kadriu-Podivorica, znj.Fatlume Jaha, z.Shaban Bajoku, znj.Doruntina Hasani, z.Pajtim Hodolli, znj.Mrika Thaqi, të cilët munguan dhe z.Blerim Maçastena i cili është ndaluar dhe është në mbajtje nga autoritetet Serbe (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Podujevës, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Shoqatave të dala nga lufta, Familjarë të një numri të Heronjve të Llapit dhe Kosovës, z.Fadil Mulliqi, z.Naim Zhitia, Fahri Balaj, Ilaz Islami, Bajram Zejnullahu, Xhemshit Gashi, Gazmend Islami, Kadri Ajeti, Mentor Talla, Agim Talla si dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Mbledhja u hap me Intonimin e Himnit të Republikës së Shqipërisë (Himni Kombëtar) dhe Himnit të Republikës së Kosovës

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit duke i'u kërkuar mirëkuptim të pranishmëve dhe duke i'u kërkuar respektimin e masave anti covid-19

- Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z.Fatmir Gashi, theksoi, të nderuar këshilltarë të Kuvendit të Komunës së Podujevës, i nderuar Kryetar i Komunës së Podujevës, të nderuar Familje të Dëshmorëve, të nderuar përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, të dashur të pranishëm dhe qytetarë, mirë se keni ardhur në këtë seancë solemne për nderë të shënimit të “EPOPESE sË UÇK-së”.

Kam nderin e veçantë që sot bashkërisht me Ju të kujtojmë 5,6 dhe 7 Marsin e vitit 1998, ditët e sulmit të egër mbi kalanë e pamposhtur të Familjes Jashari në Prekaz.

Kujtojmë ditët kur Baca Shaban Jashari dhe Adem Jashari me familje i dolën përballë armikut, ushtrisë së një regjimi, okupatorit serb, në betejën që rihapi historinë e krenarisë sonë Kombëtare.

Aty do filloj epoka e çlirimit, epoka e lirisë.

Këto tri ditë të heroizmit do të shndërroheshin në lavdinë e Jasharajve dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pas të cilës mijëra djem e vajza, burra e gra do të rreshtoheshin në luftën për çlirimin e vendit.

Kjo betejë përcaktoi të ardhmen e popullit tanë të shumëvujtur.

Kjo sakrificë dhe lufta jonë shekullore për liri, demokraci, drejtësi u mbështetë edhe nga Bota e qytetëruar, e sidomos nga aleatët tanë në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilës duhet t'i jemi falënderues dhe mirënjohës përherë.

Duke kujtuar gjithmonë sakrificën sublime të Familjes Jashari, Heronjve, Dëshmorëve, Martirëve dhe gjithë meritoreve të kohës që nuk u ndalën së vepruari për të realizuar ëndrrën shekullore për ta çuar në vend porosinë e Dëshmorëve dhe mundin e intelektualëve për shtet sovran, ju ftoj që me një minutë heshtje t'i nderojmë të gjithë ata që ranë për lirinë e Kosovës.

Mbahet një (1) minutë heshtje në nderim të të gjithë rënëve për lirinë e Kosovës

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, lavdi të gjithë të rënëve për lirinë e vendit tonë.

Tani ftoj për një fjalë rasti Kryetarin e Komunës së Podujevës.

- Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës

z.Shpejtim Bulliqi, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, të nderuar asambleistë, të nderuar Ekzekutiv i Komunës, të respektuar përfaqësues të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, Familjarë të Dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës, të nderuar mysafirë, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave dhe ju të pranishëm të tjerë, jemi mbledhur sot në këtë seancë solemne për ta shënuar “Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” dhe për të shprehur nderimin dhe mirënjohjen tonë të thellë për veprën dhe sakrificën e jashtëzakonshme të komandantit legjendar Adem Jashari, familjes së tij, Dëshmorëve të Kombit si dhe të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës.

Sot është datë e shënuar për historinë e vendit tonë, 23 vite më parë, më 5 mars, forca të shumta të policisë e ushtrisë serbe kishin rrethuar shtëpitë e Jasharëve në Prekaz. Kjo nuk ishte hera e parë që po sulmohej kjo familje, por asnjë sulm nuk i zmbrapste e as nuk i dobësonte, por vetëm i forconte në misionin e tyre të lavdishëm, për t'u bërë pjesë historike e lirisë së Kosovës.

Familja Jashari, është rast unik në botë, ku për lirinë e atdheut të tyre, për tre ditë rresht do të luftonin dhe në fund do të flijoheshin tre breza të një familje të madhe.

Heroizmi dhe sakrifika e kësaj familjeje ia shpalosi botës demokratike pamjet e errëta të regjimit totalitar serb dhe lirinë e synuar nga populli i Kosovës, në anën tjetër.

Pamjet e fëmijëve, të grave e të pleqve, të rënë në prapësi e shtëpisë së tyre, u shndërruan në thirrje për mbrojtjen e vlerave humane, por, më shumë se kaq, ato prekën në ndërgjegjen e botës së qytetëruar, e cila duhej ta mbronte një popull të shtypur dhe keqtrajtuar për dekada të tëra.

Të nderuar të pranishëm, sakrifika e familjes Jashari mbi të gjitha qëndron në vlerën universale të besimit të njeriut në liri dhe pavarësi, prandaj si e tillë u bë model unikat në historinë Kombëtare dhe botërore.

Beteja e 5, 6 dhe 7 marsit ishte betejë që përcaktoj të ardhmen e Shqiptarëve për një jetë të re. Kosova u bë shtet si shkak i gjakut të derdhur brez pas brezi. Flijimi për liri i Adem Jasharit e mbylli një kapitull të dhimbshëm, por e hapi një etapë të re për popullin tonë.

Kosova e ëndrrave tona nuk mund të jetë thjesht vetëm shtet i pavarur. Kosova e ëndrrave tona është vendi i mundësive për secilin qytetar të saj. Mbi të gjitha, ky është borxh ynë ndaj atyre që po nderojmë sot. Ky është obligim ndaj gjeneratave të ardhshme të Republikës së Kosovës, dhe në këtë rrugë po angazhohemi çdo ditë, duke realizuar projekte që ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve tanë dhe për ta bërë vendin tonë ashtu siç e duam dhe siç e meritojnë qytetarët tanë.

Të dashur qytetarë, për Epopenë e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjen Jashari janë thënë shumë fjalë të merituar, por unë sot, këtë fjalë rasti do ta mbyllë me deklaratën e administratorit të parë ndërkombëtar të Kosovës zotëri Bernard Kouchner, dhe atë, *Bota filloi të lëvizte pikërisht prej Prekazit, u bëmë të vetëdijshëm për një realitet të sakrificave dhe luftimeve që u bënë këtu, sikur të ketë një çmim nobel të lirisë, ai i takon Familjes Jashari.*

I bekuar qoftë kujtimi për familjen Jashari dhe të gjithë Heronjtë dhe të rënë për liri!

- Fjalë rasti e përfaqësuesit të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së

z.Fadil Mulliqi, në emër të Shoqatave të dala nga lufta, theksoi, të nderuar të pranishëm, familjarë të Dëshmorëve, veteran e invalidë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ju asamblistë dhe asamblistë, i nderuar Kryesues i Kuvendit, shumë i respektuari Kryetar i Komunës profesor Shpejtim Bulliqi.

Epopenë e UÇK-së e kemi shënuar çdo vit e Dëshmorit i kemi përkujtuar në çdo përvjetor të rënies së tyre, por asnjëherë si sot ndoshta sa na gëzon fakti i shënimit të kësaj date në Institucionet e Komunës 2 dekada pas luftës, po kaq të erriton fakti që lufta jonë nuk është çmuar dhe vlerësuar sa duhet nga institucionet që dolën si rezultat i asaj lufte. Sidoqoftë fakti që sot jemi këtu dëshmon një qasje ndryshe që çmon vlerat dhe luftën çlirimtare, si përfaqësues i Organizatës së Vetëanëtarëve, i jam falënderues institucioneve Komunale.

“Epopeja e UÇK-së”, nuk është lokale e as regjionale, ajo shënon kumtin e luftës dhe të çlirimit dhe si e tillë është e të gjithëve. Rezistenca e familjes Jashari deri në vetëflijim si shembulli i paparë në histori të lavdishme të popujve në botë na obligon të punojmë drejtë e ndershëm për të mirën e përgjithshme.

Në dy dekadat e shkuara patëm ngecje, u bënë shumë gabime dhe e mira e përbashkët sikur nuk ishte prioritet, shpresoj që gabimet të na kenë mësuar diçka dhe e ardhmja të jetë ndryshe, të jetë siç e ka ëndërruar familja Jashari dhe të gjithë Dëshmorët e tjerë, të ecim drejtë dhe ndershëm në shërbim të atdheut.

Lavdi Familjes Jashari, lavdi të gjithë Dëshmorëve të UÇK-së.

***Kryesuesi i Kuvendit**, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje në këtë seancë, dhe duke i uruar ditën e shpalljes së pavarësisë, e mbylli/përfundoi këtë mbledhje.*

Mbledhja përfundoi në ora 10:25

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0021227/21

Podujevë,

05 mars 2021

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi